

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik “Rikonstruksion i Rrugëve në Qytet – Rruga “Çel Islami”.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me “Rikonstruksion i Rrugëve në Qytet – Rruga “Çel Islami”.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet **online në faqen web të bashkisë Durrës për periudhën 4 Shkurt – 9 Shkurt 2026.**

Sugjerimet/komentet/rekomandimet janë të mirëpritura deri më datë 9 Shkurt 2026, në adresën e emailit:

keshillidurres@gmail.com

Pjesëmarrës:

- Këshilli Bashkiak dhe Administrata e Bashkisë Durrës
- Banorët e Bashkisë Durrës, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, përfaqësues të komuniteteve fetare në Durrës, grupe të ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.

Forma e konsultimit: Online.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik synon përfshirjen e mendimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me përmirësimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe garantimin e aksesit normal dhe të sigurt për banorët e zones si dhe vlerësimin paraprak të objekteve të shpronësimit dhe i masës së shpërblimit që parashikohet për secilin pronar privat. Rruga “Çel Islami” shërben si e vetmja lidhje rrugore për 10 banesa, të cilat aktualisht nuk kanë akses rrugor funksional. Ky proces është një mundësi e rëndësishme për qytetarët për të pasur akses të mirë të qarkullimit rrugor dhe lëvizshmëri sa më të shpejt për të arritur destinacione të rëndësishme.
Përshkrimi i çështjes.	Në gjendjen aktuale, rruga “Çel Islami”: - ka gjerësi minimale, e kalueshme vetëm për një karrocë dore; - jashtë çdo standardi minimal teknik; - nuk lejon qarkullimin e automjeteve, përfshirë ambulancën, zjarrfikësen apo mjetet e shërbimeve publike; është pa ndriçim publik; - është pa sistem kanalizimesh dhe kullimi; - paraqet rrezik real për sigurinë e banorëve, veçanërisht për fëmijët, të moshuarit dhe në raste emergjente. Këto kushte e bëjnë ndërhyrjen jo vetëm të nevojshme, por të domosdoshme dhe urgjente, në funksion të interesit publik.

Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit më poshtë, BRENDA DATËS 9 Shkurt 2026. keshillidurres@gmail.com
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me cështjen që konsultohet.	Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë, faqja kryesore. https://durres.gov.al/category/bashkia/njoftime/ https://durres.gov.al/konsultimet-publike/
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike, Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e Komisioneve të mësipërme të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në plan dhe në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 7. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 8. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	04.02.2026